

LIGJ
Nr. 14/2026

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8891, DATË 2.5.2002,
“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONEVE HETIMORE
TË KUVENDIT”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e deputetëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 4, pika 2, pas fjalës “hetimin” shtohet togfjalëshi “dhe pyetjen e dëshmitarëve”.

Neni 2

Në nenin 5, pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Në çdo rast palët janë të detyruara të bashkëpunojnë për arritjen e një formulimi konsensual lidhur me objektin e hetimit.”.

Neni 3

Në nenin 13 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 4 togfjalëshi “shumicës së anëtarëve që kërkon kjo lloj vendimmarrje” zëvendësohet me togfjalëshin “ndërmjetëm të komisionit”.

2. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Kërkesa për pyetjen e dëshmitarëve ose marrjen e provave të tjera, pasi ka filluar shqyrtimi, mund të ngrihet nga çdo anëtar komisioni dhe refuzohet vetëm me vendim të ndërmjetëm dhe të arsyetuar të komisionit.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 28.1.2026.

Shpallur me dekretin nr. 51, datë 9.2.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.